



## NJOFTIM PËR KONKURIM PËR VEND PUNE

Datë 15/04/2019

Në zbatim të Ligjit nr.16, date 18/04/2018 “Për diasporën”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave për krijimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën nr. 469, datë 26.07.2018 si dhe Ligjit nr. 7961, datë 12. 7. 1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, QBD do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” konkursin për pozicionin:

### **1 Specialist Jurist në Sektorin e Financës dhe shërbimeve Mbështetëse pranë QBD-së**

Kategoria e pagës për këtë pozicion është IV-a.

#### **Përshkrimi përgjithësues i punës për këtë pozicion:**

1. Ofron këshillim ligjor, sipas kërkesës, për drejtorin dhe sektorët me qëllim aplikimin e drejtë të ligjit;
2. Koncepton të gjitha aktet administrative dhe shkresa të ndryshme që nxirren nga QBD-ja në përputhje me ligjin;
3. Harton të gjitha aktet administrative sipas procedurave ligjore që parashikohen në Kodin e Procedurave Administrative, Kodin e Punës dhe në legjislacionin në fuqi në lidhje me emërimin, masat disiplinore dhe largimin nga detyra të punonjësve dhe mban regjistrin e tyre, duke bërë përditësimin sipas rastit;
4. Harton të gjitha kontratat që QBD-ja lidh me subjekte të ndryshme, qofshin këta persona fizikë apo juridike;
5. Përfaqëson QBD-në në të gjitha nivelet e gjykatave për çështjet ku ajo është palë apo palë e interesuar me qëllim mbrojtjen e interesave të institucionit;
6. Bën interpretimin juridik të korespondencës zyrtare që ka të bëjë me punën e QBD-së;
7. Asiston, sipas kërkesës, në përgatitjen e të gjithë projektkontratave të kërkuara për krijimin e marrëdhënieve ligjore me palët e treta duke ofruar opinionin ligjor përkatës;
8. Kontrollon, dhe kur është e nevojshme, harton të gjitha aktet ligjore (ankimime, rekurse, pretendime, prapësime, akt-ekspertime etj.) për sigurimin e një përfaqësimi sa më të denjë të QBD-së në të gjitha nivelet e gjykatës;
9. Raporton periodikisht tek eprori përkatës në lidhje me shkresat që i adresohen drejtorisë, kthimin e përgjigjeve si dhe statistika të tjera të aktivitetit ditor;
10. Nën drejtimin e drejtorit, siguron të dhënat e nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion për përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;
11. Përgjigjet tek drejtori për menaxhimin e çështjeve që lidhen me procedurat e prokurimit për t'u zhvilluar në institucion, duke bashkëpunuar edhe me sektorët e tjerë për realizimin e planit të vjetor të prokurimit;
12. Është personi përgjegjës që merret me administrimin e dosjeve të punonjësve dhe të masave disiplinore të dhëna ndaj tyre;



13. Zbaton kërkesat e Ligjit nr 9643 datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM Nr 914, datë 29.12.2014 si dhe udhëzimet përkatëse deri në raportimin përfundimtar të ekzekutimit të kontratës;
14. Përgatit shkresa përcjellëse, kthim përgjigje apo korrespondencë tjetër të nevojshme me institucione publike ose kompani private sipas detyrave të dhëna dhe afatit të përcaktuar nga përgjegjësi i sektorit/drejtori i QBD-së;
15. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Drejtori i QBD-së në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe brenda objektivave të punës së tij.

### **Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e konkurimit publik:**

Të jetë shtetas shqiptar;  
Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;  
Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;  
Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;  
Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;  
Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;  
Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;

### **Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:**

- a - Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Shkenca Juridike;
- b - Të kenë të paktën 4 vite përvojë pune në profesion nga te cilat te paktën 3 ne prokurime;
- c - Të kenë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze

### **Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

Jetëshkrimi CV;  
Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;  
Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);  
Fotokopje të letërnjoftimit (ID);  
Vërtetim të gjendjes shëndetësore;  
Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;  
Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.



**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave të bëhet brenda datës 26/04/2019, në Zyrën e Protokollit të QBD-së pranë Kryeministrisë dhe në postën elektronike të QBD-së [info@qbd.gov.al](mailto:info@qbd.gov.al)**

Në datën 30/4/2019, QBD do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për të vijuar me testimin, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet për tu futur në dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga QBD për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

**Kandidatët do të testohen në lidhje me:**

- Njohuritë mbi Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Njohuri mbi Ligjin nr.16, date 18/04/2018 “Për diasporën”;
- Njohuri mbi VKM nr. 469, date 26.07.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”;
- Njohuri mbi Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 , i ndryshuar “Për prokurimin publik“;
- Njohuri mbi Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”

**Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**  
Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv

**Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Qendra e Botimeve për Diasporë (QBD) do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen zyrtare të Ministrit të Shtetit për Diasporën,. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga QBD-ja, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).